



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

KONTRATË

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

dhe

WAVE PARTNERS, SHPK, Prishtinë, Rr. Ali Vitia, nr. 61; Tel: +383 46 820 720; NUI: 810146557;
E-mail: contact@wavecreativeagency.com (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve")

janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet në vijim:

Logoja e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Numri i prokurimit: 101-24-1314-4-2-3 (KU101 24 006 423)

Neni 1

Autoriteti Kontraktues, Kuvendi i Republikës së Kosovës, përmes procedurës së Konkursit të Projektimit, e ka përzgjedhur fitues operatorin ekonomik **Wave Partners**, Prishtinë, në aktivitetin e prokurimit **Logoja e Kuvendit të Republikës së Kosovës**.

Neni 2

Ofruesi i shërbimeve, pas vlerësimit përfundimtar nga Autoriteti Kontraktues, është radhitur i Pari dhe sipas kushteve të Konkursit shpërblehet me vlerën e paraparë prej 7,000.00 € (shtatë mijë euro).

Neni 3

Ofruesi i shërbimeve ka deklaruar në ofertë dhe deklaroi sërish me përgjegjësi se Logoja e Kuvendit, me të cilën ka konkurruar dhe është përzgjedhur fituese, është origjinale, unike dhe nuk është imitim i ndonjë logoje ekzistuese.

Neni 4

Logoja e Kuvendit, e përzgjedhur përmes këtij aktiviteti të prokurimit, me nënshkrimin e kësaj kontrate nga palët, bëhet pronë e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 5.

Ofruesi i Shërbimeve, pas nënshkrimit të Kontratës, e dorëzon faturën, numrin e llogarisë dhe emrin e bankës. Në faturë duhet të shënohet shërbimi i ofruar për të cilin do t'i bëhet pagesa.

Neni 6.

Autoriteti Kontraktues, pas protokollimit të faturës së pranuar, do t'ia bëjë pagesën ofruesit të shërbimeve brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh.

Neni 7




Mosmarrëveshjet eventuale ndërmjet palëve, të cilat mund të lindin lidhur me këtë kontratë, nëse është e mundur do të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.


Neni 8.

Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën **shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Shtojcë

Kontratës i bashkëngjitet kopja e logos së përzgjedhur dhe Deklarata e Ofruesit të shërbimeve lidhur me origjinalitetin e logos.

Për Autoritetin Kontraktues KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS		Për Ofruesin e Shërbimeve WAVE PARTNERS	
Emri dhe mbiemri	Xhemail Halili	Emri dhe mbiemri	Naser Petrovi
Pozita:	Drejtor i Drejtorisë për Prokurim	Pozita:	CEO
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05.07.2024	Data:	05.07.2024
Vula:		Vula:	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

Kuvendi - Skupština - Assembly



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

Kuvendi - Skupština - Assembly




Dëshmitë për kërkesën nr.2

Deklaratë me shkrim

Ne, Wave Partners Sh.P.K Prishtine, me NRU: 810146557, zyrtarisht dëshmojmë se logoja e dizajnuar është origjinale, unike dhe nuk është imitim i ndonjë logoje ekzistuese.

Kjo deklaratë është nënshkruar dhe e vulosur në 27.03.2024

A handwritten signature in black ink is written over a circular stamp. The stamp contains the text "WAVE PARTNERS SH.P.K." at the top, "PRISHTINE" on the right side, and "NRU: 810146557" at the bottom. The word "WAVE" is repeated in a stylized, wavy font across the center of the stamp.
Faton Citaku, Drejtor i përgjithshëm

+383 46 820 720 | +383 49 810 11

www.wavecreativeagency.com